



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr/17 /2011
Data: 02/03/2011

Në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 15, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 24.02.2011 merr këtë:

VENDIM
PËR
APROVIMIN E PLANIT TË MBLEDHJEVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË HANIT
TË ELEZIT PËR VITIN 2011

I

Me këtë Vendim Aprovohet Plani i Mbledhjeve të Rregullta të Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit, që do të mbahen gjatë vitit 2011

II

Kuvendit i Komunës së Hanit të Elezit në vitin 2011, Planifikon të i mbajë gjithsej: 11 Mbledhje të Rregullta

III

Mbledhjet e Rregullta të Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit, do të mbahen sipas periudhës kohore, të paraqitura si në tabelë:

Mbledhja	Temat që do të diskutohen	Afati i realizimit
Mbledhja e (I)	<ul style="list-style-type: none">Propozim vendim për themelimin e një Komisioni për përgatitjen e materialit për padi kundër Serbisë për krimet e kryera në territorin e Hanit të Elezit gjatë viteve 1989-1999Miratimi i Raportit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2010.Miratimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2010.Miratim i raportit të punës së Kuvendit për vitin 2010.Miratimi i raportit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2010.	Janar
Mbledhja e (II)	<ul style="list-style-type: none">Miratimi i Planit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2011.Miratimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2011.Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor 2010-2011.	Shkurt
Mbledhja e (III)	<ul style="list-style-type: none">Shqyrtimi i Projekt rregullore për Taksa, tarifa dhe ngarkesa.Shqyrtim i Projekt rregullore për tatim në pronë.Miratimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Planit Zhvillimor Urban PZHU. (Mars-Prill)	Mars

Mbledhja e (IV)	<ul style="list-style-type: none"> • Miratimi i Rregullores për Taksa, tarifa dhe ngarkesa. • Miratimi i Rregullores për tatim në pronë 	Prill
Mbledhja e (V)	<ul style="list-style-type: none"> • Shqyrtimi i Projekt Rregullores për lejet e punës së subjekteve afariste si dhe funksionimi i tyre • Shqyrtimi i Projekt Rregullores për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre 	Maj
Mbledhja e (VI)	<ul style="list-style-type: none"> • Miratimi i Rregullores për lejet e punës së subjekteve afariste si dhe funksionimi i tyre • Miratimi i Rregullores për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre 	Qershor
Mbledhja e (VII)	<ul style="list-style-type: none"> • Miratimi i rishikimit të Buxhetit për vitin 2011. • Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2010-2011. • Miratimi i raportit gjashtëmujor të punës së Kryetarit të Komunës. • Miratimi i Raportit gjashtëmujor i shpenzimeve buxhetore 	Korrik
	<ul style="list-style-type: none"> • Pushimi vjetor i Këshilltarëve të Kuvendit të Komunës • Mbledhje solemne me rastin e 29 Gushtit Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Hanit të Elezit. 	Gusht
Mbledhja e (VIII)	<ul style="list-style-type: none"> • Miratimi i Buxhetit për vitin 2012 • Informatë e DKA-së për fillimin e vitit të ri shkollor 2011/2012. 	Shtator
Mbledhja e (IX)	<ul style="list-style-type: none"> • Miratim i raportit të suksesit të arritur në fund të vitit shkollor 2010/2011 • Shqyrtimi i Projekt rregullores për qasje në dokumente zyrtare • Shqyrtimi i Projekt Rregullores për Kompensimin e Udhëtimeve zyrtare dhe pagesën e mëditjeve 	Tetor
Mbledhja e (X)	<ul style="list-style-type: none"> • Shqyrtimi i Rregullores për rregullimin e Transportit rrugor dhe publik në Komunën e Hanit të Elezit • Miratimi i rregullores për qasje në dokumente zyrtare • Miratimi i Rregullores Për Kompensimin e Udhëtimeve zyrtare dhe pagesën e mëditjeve 	Nëntor
Mbledhja e (XI)	<ul style="list-style-type: none"> • Miratimi i Rregullores për rregullimin e Transportit rrugor dhe publik në Komunën e Hanit të Elezit 	Dhjetor

IV

Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit gjatë vitit 2011, mund të mbajë edhe mbledhje tjera të Rregullta më shumë se minimumi i paraparë me aktet në fuqi. Të gjitha mbledhjet e Rregullta do të mbahen vetëm ditëve të punës.

V

Të gjitha mbledhjet e Rregullta të Kuvendit të Komunës do të jenë të hapura për qytetarë dhe përfaqësues të mediave publike. Nëse ndonjë mbledhje e Rregullt apo pjesë e mbledhjes do të mbahet me dyer të mbyllura atëherë për këtë duhet të vendosë Kuvendi i Komunës. Nëse mbledhja mbahet me dyer të hapura, në mbledhjet mund të marrin pjesë qytetarët e komunës dhe përfaqësues të mediave në përputhje me kushtet dhe mundësitë fizike.

VI

Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe mbledhje tjera, varësisht prej nevojave që paraqiten

VII

Njoftimet për mbledhje të Kuvendit të Komunës bëhen publike. Materialet për Mbledhjet e Rregullta të Kuvendit të Komunës iu dorëzohen të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes. Njoftimet dhe Materiali i mbledhjes i dërgohet edhe Ministrisë së Pushtetit Lokal.

VIII

Plani i Mbledhjeve të Kuvendit, i përcaktuar si në pikën III të këtij Vendimi , është orientues e nuk do të thotë se nuk pëson ndryshime.

IX

Plani i Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës për vitin 2011, ka fuqi veprimi nga muaji Janar deri në muajin Dhjetorë të vitit 2011.

X

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit, me këtë vendim njoftohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Menduh Vlashi

